



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 55, Datë 29.10.2007

**“PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT ARTISTIKO - KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN
E ANËTARËVE TË TIJ”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë.31.07.2000 neni32/d “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.540, date 21.12.1992, ndryshuar me V.K.M.–në Nr.121, dt.25.02.2005, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, dt.21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillave të Kultures dhe shperblimin e tyre”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ,

V E N D O S I:

1. Të krijohet Këshilli Artistiko - Kulturor, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Z. Ilir Butka	Regjisor
2. Z. Fidel Ylli	Sportist – KOKSH
3. Z. Mehmet Xhelili	Pedagog në Akademinë e Arteve
4. Z. Genc Fuga	Regjisor
5. Z. Vladimir Myrtezai	Piktor
6. Z. Bashkim Zahaj	Skenograf
7. Z. Gazmend Çaçi	Sportist
8. Znj. Mariana Leka	Soprano
9. Z. Donard Hasani	Pedagog në Akademinë e Arteve

2. Anëtarët e Këshillit Artistik-Kulturor, të shpërblehen me 4.000 lekë (katërmijë leke) në muaj, kur zhvillojnë mbledhje.

3. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Artistiko - Kulturor, do të përballohen nga shpenzimet operative (Art.602) të Aparatit të Bashkisë, miratuar me Buxhetin e vitit 2007.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.27, Datë 23.05.2005 shfuqizohet.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R